

REZOLUTË

PËR RAPORTIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM “MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2013”

Kuvendi i Shqipërisë konsideron se:

- Prokuroria e Republikës së Shqipërisë është institucioni kushtetues që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit;
- Prokuroria e Përgjithshme, bazuar në Kushtetutë dhe në ligj, luan rol drejtues në hetimin dhe luftimin e formave të ndryshme të shfaqjes së krimit, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe korrupsionit;
- Pavarësia, ligjshmëria, përgjegjshmëria dhe pakorruptueshmëria janë parimet bazë që duhet të udhëheqin Prokurorinë në ushtrimin e ndjekjes penale efikase dhe të suksesshme;
- Standardet bashkëkohore që kërkon procesi i integritetit në Bashkimin Europian duhet të jenë fokusi qendror i Prokurorisë për realizimin e objektivave dhe arritjen e rezultateve pozitive;
- Raportimi për gjendjen e kriminalitetit në Kuvend është përmbushja e detyrimit kushtetues dhe ligjor për organin e Prokurorisë për të analizuar punën e tij dhe për të vendosur përparësitë në luftën kundër kriminalitetit, në të gjitha format e shfaqjes së tij.

Konstaton për vitin 2013 se:

- Në krahasim me vitin 2012, numri i procedimeve penale të regjistruara është rritur. Është ulur numri i kallëzimeve të shtetasve, të nëpunësve publikë ose mbi bazë ankimi. Referimet nga Policia e Shtetit janë rritur.
- Është rritur numri i procedimeve penale të mbartura, të pezulluara dhe çështjeve të përfunduara. Është ulur numri i procedimeve të pafilluara, të rifilluara dhe të pushuara.
- Është rritur numrit i përgjithshëm i të pandehurve, i masave të sigurimit personal dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë. Numri i të pandehurve të mitur është ulur.
- Vendimmarrja e gjykatës për pushimin e çështjeve, për pushimin e akuzës për të pandehurit është ulur, ndërsa për pafajësinë konstatohet rritje.
- Gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në gjykim, kërkesat e prokurorëve për dënimin e të pandehurve me gjobë, për dënimin me burgim në maksimum dhe për dënimin me burgim të përjetshëm janë ulur; kërkesat e prokurorëve për masën e dënimit me burgim në minimum dhe dënimin me kusht janë rritur. Ka rritje të numrit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë të ekzekutuara.
- Faktorët kriminogjenë që kanë ndikim në rritjen e kriminalitetit rezultojnë të jenë gjendja shoqërore, niveli i ulët arsimor dhe ekonomik e papunësia.
- Veprat penale të kryera nga organizata ose grupe të strukturuar të krimit të organizuar të hetuara rezultojnë në të njëjtat nivele me vitin 2012.

- Është aplikuar sistemi i menaxhimit të rasteve si mekanizëm që do të mundësojë gjenerimin e statistikave dhe koordinimin në kohë reale me Policinë e Shtetit, si dhe do të ndikojë në forcimin e kontrollit të brendshëm në organin e Prokurorisë.

- Vijnë përparësitë për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe hetimore të organit të Prokurorisë dhe të prokurorëve e oficerëve të Policisë Gjyqësore në përdorimin e metodave të specializuara të hetimit të krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

- Në kuadër të transparencës institucionale është vendosur një adresë online për denoncimin e rasteve abuzive të punës së prokurorëve.

- Bashkëpunimi i Prokurorisë së Përgjithshme me Kuvendin e Shqipërisë ka rezultuar institucional për sa i përket ndryshimeve në legjislationin që ka lidhje me punën e organit të akuzës.

- Marrëdhëniet institucionale me Ministrinë e Drejtësisë kanë funksionuar mbi baza ligjore dhe institucionale, veçanërisht në drejtim të ushtrimit të kontrolleve dhe inspektimeve.

- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja janë zgjeruar me rritjen e numrit të ekstradimeve të shtetasve nga jashtë brenda dhe anasjelltas. Është rritur numri i letërporosive nga jashtë dhe për jashtë.

Kuvendi kërkon nga Prokuroria për vitin 2014:

1. Të veprojë me efikasitet në bazë të një strategjie afatmesme për luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, krimit të organizuar e korrupsionit në veçanti, bazuar në rekomandimet e Progres-Raportit të BE-së dhe të partnerëve ndërkombëtarë, si dhe të strategjive kombëtare dhe studimeve e analizave në fushën e kriminalitetit në vend.

2. Të konsiderojë prioritet kyç të punës së tij luftën kundër korrupsionit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndëshkimit të korrupsionit në radhët e zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve në administratën qendrore e vendore dhe në sistemin e drejtësisë. Kjo do të kërkojë:

- i) forcimin e hetimeve proaktive;
- ii) ashpërsimin e politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit në rastet e korrupsionit dhe fshehjes së pasurive, produkte të veprës penale;
- iii) shkurtimin e afateve të hetimit për veprat penale të korrupsionit;
- iv) rritjen e përgjegjësisë dhe forcimin e rolit koordinues e kontrollues të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në hetimin e veprave korruptive;
- v) riorganizmit më të mirë të strukturave hetimore në fushën e korrupsionit në prokuroritë e rretheve dhe në Prokurorinë e Përgjithshme;
- vi) fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të strukturave të hetimit të veprave penale të korrupsionit përmes forcimit të integritetit moral dhe rritjes së trajnimit specifik të tyre;
- vii) mbështetjen më të mirë financiare e logjistike të këtyre strukturave;
- viii) evidentimin dhe dokumentimin sa më efektiv të këtyre proceseve hetimore dhe rezultateve të tyre;
- ix) forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë e tjera ligjzbatuese për shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin sa më efektiv të metodave speciale të hetimit, për sigurimin e provave dhe goditjen e korrupsionit. Brenda vitit të raportojë në Kuvend për rezultatet konkrete në zbatimin e këtij prioriteti të rëndësishëm.

3. Të vijojë intensifikimin e luftës ndaj të gjitha formave të krimit, trafikeve dhe krimit të organizuar, veçanërisht në forcimin dhe ashpërsimin e politikës penale ndaj këtyre veprave penale dhe në përgjithësi ndaj veprave penale që cenojnë rendin dhe sigurinë në vend dhe sidomos ndaj të pandehurve me rrezikshmëri të madhe shoqërore apo përsëritës për të njëjtat apo vepra të ndryshme penale.

4. Të konsiderojë pozitivisht rekomandimin e Qeverisë për zbatimin më efektiv të masave alternative të dënimit, të cilat sigurojnë rehabilitimin e personave të dënuar me masë dënimi deri në 5 vjet burgim dhe kanë rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe veçanërisht ndaj grave e të miturve.

5. Të rrisë efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale në hetimet paraprake, duke rritur pjesëmarrjen e prokurorit në kontrollin dhe kryerjen e hetimeve, veçanërisht këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe veprimet hetimore të papërsëritshme; të rrisë efektivitetin dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit dhe të garantojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

6. Të intensifikojë bashkëpunimin dhe të sigurojë mirëfunksionimin e njësive të përbashkëta hetimore, duke kërkuar nga institucionet nënshkruese përbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Memorandumin e Krijimit të Njësive të Përbashkëta Hetimore dhe plotësimin e numrit të personelit të caktuar në këto njësi.

7. Të forcojë marrëdhëniet institucionale me institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, si: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ILDKPKI etj., me qëllim për të orientuar një vizion të përbashkët në politikën që do të ndiqet për luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, korrupsionit dhe krimit të organizuar në veçanti; të rekomandohet nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme për Inspektimet.

8. Të forcojë bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të Policisë Gjyqësore, rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimeve.

9. Të vijojë rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë homologe, duke i dhënë përgjigje në një kohë të shpejtë dhe me efikasitet të gjitha rasteve të shkëmbimit të informacionit për ekstradimet, urdhër-arrestet ndërkombëtare ose letërporositë.

10. Të përmirësojë ndjeshëm procesin e llogaridhënies së Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, përmes forcimit të kontrollit të brendshëm në radhët e prokurorisë, fuqizimit e aftësimit të strukturave inspektuese; përsosjes së procedurave për emërimet dhe largimet e personelit të prokurorisë; rritjes së transparencës së këtij procesi; ridimensionimit dhe forcimit të rolit të Këshillit të Prokurorëve, rritjen e përgjegjshmërisë profesionale për ruajtjen e sekretit hetimor, në zbatim të detyrimeve që parashikon legjislacioni procedural penal, duke marrë masa të ashpra ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjit.

Miratuar në datën 3.7.2014

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

